

AKT THEMELIMI

Sot ne dt. 13/03/2023 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",
ARTAN DEMIRI i datelindjes 20-03-1972, e lindur ne SARANDE, SHQIPERI, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID H20320166H ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 08/01/2021,
i cili me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin "**DEANXHELO**" shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**DEANXHELO**" shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria "**DEANXHELO**" shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**DEANXHELO**" shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Lagjia nr. 4, Rruga Ismail Qemali , godina me nr. Pasurie 25/115, Zona Kadastrale 8641, kati i pare ,Sarande.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Operator turistik,sherbime turistike ne det dhe ne toke.

Shetitje me Varke Turistike te pushuesve.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

KREU II
KAPITALI



Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 10,000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: **ARTAN DEMIRI**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 10,000 Leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise.

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar **10,000 Leke.**

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **10,000 Leke**, do te paguhet ne avance nga ne ortaket. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga dy administrator te perbashket.

Administratoret e shoqerise jane **Z.ARTAN DEMIRI** i datelindjes 20-03-1972, e lindur ne SARANDE, SHQIPERI, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID H20320166H ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 08/01/2021 dhe **Z.NERTIL HOXHA** i datelindjes 30-07-1991, i lindur ne Vagalat, SHQIPERI, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID J10730075R ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 12/04/2022

Administratoret emerohen me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, te cilet kane te gjitha kompetencat per te kryer bashkarisht te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratoret kane kompetencat si me poshte:

Administratori **ARTAN DEMIRI** i cili eshte ortaku i vetem i shoqerise ka te gjitha kompetencat e plota dhe te pakufizuara qe te veproje i vetem, i pavarur ne perputhje me statutin dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per te gjitha veprimet e nevojshme lidhur me aktivitetin ekonomik te shoqerise.

Administratori **NERTIL HOXHA** do te kete te drejte te veproje i pavarur dhe i vetem ose bashkarisht me Administratorin **ARTAN DEMIRI** per te gjitha vprimet qe lidhen me aktivitetin ekonomik te shoqerise ne perputhje me statutin dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" pervec kufizimit ne veprimet ne llogarite bankare dhe te veprimeve ne arken e shoqerise ku **Administratori NERTIL HOXHA do te kete vetem te drejten qe te kryeje derdhje te mjeteve monetare ne llogarine bankare ose ne arken e shoqerise dhe nuk ka te drejte te kryeje asnje veprim tjeter ne llogarite bankare dhe ne arken e shoqerise.**

Administratoret angazhojne shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratoret ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfare do shkakut, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene

a. Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimet të metejshem të veprimtarise se saj.

b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfare do ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italiane dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqerise tregtare "**DEANXHELO**" shpk, nenshkruhet


ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij origjinale.

ORTAKU I VETEM

ARTAN DEMIRI

ADMINISTRATORET

ARTAN DEMIRI



NERTIL HOXHA

